



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.11.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 31.10.2022, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Roza Komani B.I**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “Ndërtimi dhe sanimi i parqeve “ , Nr. i prokurimit- 632-22-4421-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-020-521, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pa bazuar Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **Roza Komani B.I**, e dt.31.10.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi dhe sanimi i parqeve “ , Nr. i prokurimit- 632-22-4421-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-020-521, kundër **NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** , te AK – së, të datës 26.10.2022, të publikuar në platformën elektronike të KRPP.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES** të publikuar me datë 26.10.2022;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me procedurat e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe të publikohet në platformën elektronike të KRPP.

A r s y e t i m

Me dt.31.10.2022, Operatori Ekonomik " **Roza Komani B.I.**, ka parashtruar Kërkesë për rishqyrtim lidhur me aktivitetin prokurimit: "Ndërtimi dhe sanimi i parqeve ", **Nr. i prokurimit- 632-22-4421-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-22-020-521.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 03.11.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues ka vepruar **duke u mbështet në Vendimit te Organit Shqyrtues te Prokurimit PSH.nr.289/22 te datës 20.09.2022.**

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës